



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

Nr. 8664/1 prot.

Tiranë, më 8.7.2020

Lënda: Dërgohet Udhëzimi plotësues “Për një shtesë në udhëzimin plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”.

MINISTRIA/ INSTITUCIONI \_\_\_\_\_

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

DEGA E THESARIT \_\_\_\_\_

Mbështetur në ligjin nr. 88/2019 “Për Buxhetin e vitit 2020” dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, bashkëlidhur ju përcjellim Udhëzimin plotësues nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, “Për një shtesë në udhëzimin plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”.





**UDHËZIM PLOTËSUES**

8664

Nr. 26 datë

8.7.2020

**“PËR**

**NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN PLOTËSUES NR. 2, DATË  
20.01.2020 ‘PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2020’”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit 88/2019, “Për Buxhetin e vitit 2020” dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2.

**U D H Ë Z O J :**

Në Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, në kreun I, “Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit” bëhen ndryshimet si më poshtë:

I. Pas pikës 6, shtohet pika 6/1 me përmbajtjen:

“6/1”. Të ardhurat e realizuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës nga proceset kalimtare të pronësisë, në zbatim të nenit 67, të ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, do të kalojnë në fondin e kompensimit financiar të pronave, në masën dhe sipas procedurës së përcaktuar më poshtë:

- a) 70% e të ardhurave të krijuara nga kalimi i të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimeve pa leje kalon në llogarinë e thesarit në favor të institucionit ‘Agjencia e Trajtimit të Pronave në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7116101, për tu kaluar më pas në Fondin e Kompesimit Financiar të Pronave.
- b) 50% (80% deri më datën 30.04.2020) i të ardhurave të arkëtuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi trojet në zonat e stimuluar kalon në llogarinë e thesarit në favor të institucionit ‘Agjencia e Trajtimit të Pronave’, në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7116102, për tu kaluar më pas në Fondin e Kompesimit Financiar të Pronave.
- c) 50% e të ardhurave të krijuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sipërfaqet shtesë, sipas pikës 4, të nenit 10, të ligjit 20/2020 kalon në thesar në favor të institucionit ‘Agjencia e Trajtimit të Pronave’, në llogarinë ekonomike të të ardhurave 7116102, për tu kaluar më pas në Fondin e Kompesimit Financiar të Pronave.

Brenda datës 10 të çdo muaji, drejtoritë vendore të ASHK-së do të kalojnë pjesën takuese të të ardhurave sipas përcaktimeve si më sipër, në llogarinë e thesarit të shoqëruar me Nxjerrjet e llogarive bankare mujore të bankave të nivelit të dytë, të cilat pasqyrojnë shumat e arkëtuara.

Bazuar në rakordimet përkatëse struktura qendrore për thesarin autorizon transferimin e mjeteve monetare nga llogaria e unifikuar e thesarit, në llogarinë e fondit të kompesimit financiar të pronave pranë Bankës së Shqipërisë.

2. Germa “e” e pikës 75, dhe germa “e” e pikës 76, hiqen.

3. Në pikën 76, shtohet germa “k”, me këtë përmbajtje:

“k”. Të ardhurat që siguron Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) nga pagesat e personave jashtë shërbimit civil, për trajnimet në programin e formimit të thelluar, në programet e formimit të vazhdueshëm si edhe nga trajnimi për përgatitjen paraprake të kandidatëve për të marrë pjesë në konkurrimin e hapur për kategorinë ekzekutive. Këto të ardhura do të përdoren nga ASPA vetëm për përballimin e kostos së veprimtarisë prej së cilës janë krijuar këto të ardhura dhe konkretisht:

- Shpenzime për pagesën e trajnuesve dhe hartimin e kurrikulave
- Shpenzime për kancelari
- Shpenzime për materiale e shërbime që lidhen me trajnimin
- Shpenzime për qiramarrje ambjentesh për trajnim

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

